



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 1631/Prot.

Pogradec, më 30. 04 2025

VENDIM

Nr. 36, Datë 29. 04 2025

PËR

“MIRATIMIN E IMPLEMENTIMIT NË RAST APROVIMI TË PROJEKTIT STRATEGJIK ME TITULL “CIRCLE” NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË PARA ANTARËSIMIT, IPA III, PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR GREQI-SHQIPËRI 2021-2027”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 28, pika 1, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, , nenit 32, të Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr.450 datë 26.07.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore” pika 1 dhe 2 gërma (b) dhe (d) Koordinimi i programeve të asistencës së Bashkimit Evropian në nivel vendor dhe projekteve ku përfiton Bashkia, në lidhje me aplikimin në projektin strategjik me titull **“CIRCLE”**, në kuadër të Programit Ndërkufitar Greqi-Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Asistencës së Paraantaresimit (IPA III) 2021-2027, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Pogradec, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë implementimin në rast aprovimi të projektit strategjik me titull **“CIRCLE”**, në kuadër të instrumentit të para antaresimit, IPA III, financiar nga Programi i bashkëpunimit Ndërkufitar Greqi -Republika e Shqipërisë, 2021-2027.



2. Bashkia Pogradec, si partner në këtë projekt, bazuar në kushtet dhe kriteret e aplikimit në projekte IPA, në rastin e miratimit të projektit nga vlerësuesit e Delegacionit Evropian, të marrë përsipër mbulimin e koston së bashkëfinancimit të projektit dhe TVSH-së bazuar në buxhetin e palës shqiptare dhe përfshirjen e kësaj kostoje dhe TVSH-së në buxhet.

3. Për zbatim të këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë Pogradec, Njësia e Integrimit Evropian dhe administrata e Bashkisë Pogradec të ndjekë të gjitha hapat e duhura për ecurinë e projektit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

1.Miratuar me 17 vota

2.Vota Pro 17

3.Vota Kundër 1

4.Vota Abstenim 1

5.Zbardhur më date 30.04.2025

